



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**  
**KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE**

Tiranë më 11.03.2019  
Dokument parlamentar

**RAPORT**  
**PËR PROJEKTLIGJIN**  
**“PËR RATIFIKIMIN E LETËRMARRËVESHJES NDRYSHUESE TË**  
**MARRËVESHJES SË FINANCIMIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË**  
**SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (IDA),**  
**PËR PROJEKTIN “SIGURIA E DIGAVE”, TË RATIFIKUAR ME LIGJIN**  
**NR.9965, DATË 24.7.2008”**

• **HYRJE**

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, bazuar në nenet 32-36 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit përgjegjës shqyrtoi në mbledhjen e datës 06.03.2019 në parim, nën për nen dhe në tërësi, projektligjin *“Për ratifikimin e letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Sdërkombëtare për Zhvillim (IDA), për projektin “Siguria e digave”, të ratifikuar me ligjin nr.9965, datë 24.7.2008”*

Për të prezantuar projektligjin në komision ishin të pranishëm Zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë z. Ilir Bejtja së bashku me stafin mbështetës.

Relatore e projektligjit u caktua deputetja Antoneta Dhima .

• **BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT**

Projektligji është hartuar në përputhje me Kushtetutën si dhe me ligjin nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

- **QËLLIMI, PËRMBAJTJA DHE RISITË E PROJEKTLIGJIT**

Qëllimi i projektligjit është ratifikimi i letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së financimit për projektin “Siguria e digave”, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim, ratifikuar me ligjin nr.9965, datë 24.7.2008. Ndryshimi që synohet të miratohet nëpërmjet këtij dokumenti është rishpërndarja e fondeve të akorduara nëpërmjet kësaj marrëveshjeje nga kategoria 3 në kategorinë 2 të saj.

Objektivat kryesorë të projektit të sigurisë së digave në kuadrin e programit për komunitetin e energjisë së Evropës Juglindore janë:

- Rritja e sigurisë së digave të hidrocentraleve më të mëdha të sistemit elektroenergjetik shqiptar në kaskadat e lumenjve Drin dhe Mat;
- Rritja e sigurisë dhe cilësisë së furnizimit me energji elektrike, nëpërmjet rritjes dhe përmirësimit të efikasitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet hidrike, duke ndikuar në këtë mënyrë edhe në rritjen e qëndrueshme të sigurisë së furnizimit me energji elektrike në tregun rajonal të energjisë.

Nëpërmjet rishpërndarjes së fondeve të marrëveshjes së financimit për sigurinë e digave synohet:

- Financimi i konsulentit të implementimit të projektit për detyrat e mëposhtme, të cilat janë përfshirë në kategorinë 2 të marrëveshjes, por për shkak të punimeve shtesë të evidentuara në rehabilitimin elektromekanik të HEC-it Koman, aktivitetet i cili është pjesë e kësaj marrëveshjeje, kërkon financim shtesë për:
  - supervizionin shtesë të punimeve rehabilituese elektromekanike të agregateve në HEC-in Koman. Kjo, për arsye se kontrata me konsulentin për projektin e sigurisë digave është e tipit “*Time base contract*” dhe jo çmim fiks dhe sa herë që kërkon aktivitetet shtesë që është përfshirë në projektin e sigurisë së digave duhet amenduar kontrata e konsulentit;
  - fonde të lira të angazhuara në kategorinë 3, në shumën 300 000 euro, do të kalohen në kategorinë 2, “Shërbimet e konsulentëve”, me qëllim mbulimin e kostove për supervizionin e punimeve dhe financimin e panelit të pavarur të ekspertëve për projektin e sigurisë së digave.
- Shtyrja e datës së mbylljes deri më 31.12.2020.

Punimet shtesë të sipërcituara do të kërkojnë kohën për zbatimin e tyre dhe, në këtë kuadër, grafikët e zbatimit do të kërkojnë shtyrjen e datës së mbylljes së kredisë deri më 31.12.2020.

- **DISKUTIME**

Kryetarja e komisionit Znj.Felaj, para se t'i jepte fjalën Zvendësministrit Z.Bejtja shpjegoi arsyet pse ky projektligj po shqyrtohej në Komisionin e Sigurisë. Ajo theksoi se siguria e digave është një ndër elementët e asaj që konsiderohet si infrastrukturë kritike që lidhet edhe me një funksion të veçantë sikundër është ai që ushtron Drejtoria e Emergjencave Civile, drejtori kjo e cila përgjigjet në Komisionin për Sigurinë Kombëtare, ndaj parë nga ky këndvështrim u gjykua që ishte e nevojshme që edhe anëtarët e këtij komisioni të viheshin në dijeni të marrëveshjeve që lidhen me këtë sektor.

Mandej, Znj.Felaj i kërkoi Zvendësministri Z.Bejtja që të përqëndrohej në aspektin e sigurisë reale, në atë çfarë kjo marrëveshje sjell për sigurinë e digave.

Gjatë fjalës së tij Zvendëministri i Energjisë dhe Infrastrukturës, Z.Illir Bejtja u shpreh se projekti vazhdon prej shumë vitesh me mbështetjen financiare të Bankës Botërore dhe me fonde të garantuara nga buxheti i shtetit që i janë dhënë gjeneruesit të energjisë elektrike KESH-it për të garantuar një funksionim normal dhe të sigururt të digave të kaskadës së Drinit.

Ky projekt i përgjigjet një faze normale rehabilitimi të disa elementeve të vërejtura me disa probleme gjatë funksionimit në tre digat kryesore të kaskadës së Drinit (Hidrocentralet e Fierzës , Komanit dhe Vaut të Dejës). Janë treqindmijë euro të cilat alokohen për supervizionin e projektit në vazhdim, nga 12 milion euro të cilat janë miratuar më parë për sigurinë e digave”.

Mandej, Zvendësministri Z.Bejtja u shpreh se digat janë absolutisht të sigurta, pasi ka një rregullore të funksionimit të digave, e cila rregullon krejt regjimin e përdorimit të tyre. Në këtë rregullore janë të përcaktuar qartazi të gjithë treguesit që duhet të respektohen në shfrytëzimin e të tre liqeneve, tre ujëmbledhësve dhe të digave të cilat bëjnë të mundur krijimin e këtyre ujëmbledhësve. Në këtë kuadër, janë në vazhdim disa projekte të cilat e kanë rritur këtë siguri si psh ndryshimi i kanaleve të shkarkimit në Koman, forcimi i portave të shkarkimit në Vaun e Dejës, vetë restaurimi i turbinave në hidrocentralin e Komanit i cili vazhdon akoma dhe përfshin dhe elementë të sigurisë të funksionimit të tyre etj.

Pas këtij prezantimi relatorja si dhe anëtarët e tjerë të komisionit e vlerësuan nismën duke kujtuar se në të shkuaraën ka pasur një menaxhim jo të duhur të digave që kanë ndikuar negativisht në ekonominë e vendit dhe kërkuan që ngjarje të tilla të mos përsëritën.

Komisioni vijoi me pyetjet drejtuar Zvendësministrit, i cili iu përgjigj interesimit të anëtarëve të komisionit në lidhje me problematikat dhe sigurinë e digave.

Gjithashtu u diskutua edhe roli i Komitetit të Digave në lidhje me menaxhimin dhe sigurinë e digave. Zvendësministri Z.Bejtja u përgjigj se ky komitet merret me digat e vogla dhe rezervuarët dhe strukturat e vetme që menaxhojnë digat janë KESH, i cili ka përgjegjësi direkte administrative nga pikpamja teknike e operimit dhe mirëmbajtjes dhe strukturat e tjera që lidhen me regjimin e funksionimit të tyre brenda rregullores siç është Sekretariati i Plotave dhe Komiteti i Plotave.

Një çështje tjetër që u diskutua ishte edhe roli i bashkive në mirëmbajtjen e digave. Zëvendësministri Z.Bejtja theksoi se kalimi i digave në administrim të Bashkive (aktualisht janë 640 diga) ka krijuar një situatë jo komode pasi bashkitë nuk kanë kapacitetet teknike dhe sidomos financiare për të mirëmbajtur apo rehabilituar digat që janë në shfrytëzim. Aktualisht, po përgatitet një projekt për të parë se cilat nga këto diga kanë nevojë për rehabilitim duke marrë në konsideratë jo vetëm faktorin kohë, pasi shumë prej tyre janë diga 40 vjeçare, por edhe duke konsideruar zhvendosjen e çrregullt dhe pa kriter të popullsisë në këto zona dhe ndërtimet e shumta pranë tyre, mosfunksionimin e portave, pastrimin e digave etj.

Nisur nga sa më sipër, nga antarët e komisionit u kërkua informacion nëse ekziston ndonjë projekt i cili bën të mundur që administrimi i digave nga bashkitë t'u kalojë institucioneve qendrore, pasi kjo çështje është shumë delikate dhe kërkon ekspertizë në fushë. Kryetarja e komisionit Znj.Felaj u shpreh se duhet insistim që menaxhimi i digave t'i kalojë në administrim ministrisë, pra të rikthehen disa nga këto funksione aty ku ato janë më të natyrshme për tu ushtruar.

Lidhur me këtë çështje, Zëvendësministri Z.Bejtja u shpreh se është bërë një takim me kryetarin e Komitetit të Digave dhe strukturat e ministrisë dhe KESH-in dhe është duke u bërë një studim për verifikimin e gjëndjes së tyre fizike dhe monitorimin por akoma nuk janë ndërmarrë hapat ligjore në mënyrë që digat t'u rikthehen në administrim institucioneve qendrore.

## • PËRFUNDIM

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje e miratoi atë dhe vendosi t'ia kalojë për miratim seancës plenare, duke vlerësuar se:

- ***Në aspektin ligjor***, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.
- ***Në aspektin procedural***, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit,

**Relator**

**Antoneta DHIMA**

**Kryetar**

**Ermonela (Felaj) VALIKAJ**